



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d) dhe nenit 17, paragrafi 1, shkronja (k) lidhur me nenin 40, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e në mbështetje të dispozitave të Ligji Nr.08/L-255, për Shërbime Sociale dhe Familjare, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-1/2024" dhe konform nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 29.08.2025, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet Plani i Veprimit Komunal për Strehim Familjar për Komunën e Suharekës për periudhen 2025-2027, (në tekstin e mëtejme PLVKSF).

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Plani i Veprimit Komunal për Strehim Familjar për Komunën e Suharekës për periudhen 2025-2027, (në tekstin e mëtejme PLVKSF), me numër të protokollit 01-Nr-016-43430, i datës 24.07.2025, i hartuar nga grupi punues i themeluar me vendimin e Kryetarit të Komunës dhe nga ekspert të jashtëm të fushave të caktuara profesionale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr- 016-56048
Më datë 29.08.2025



Kryesuesi i Kuvendit
[Signature]
Mr.ec Bexhet KUÇI